

Gjykata Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë, divizioni civil, në përbërje të trupit gjykues nga gjyqtari Haki Kryeziu, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve porotë Hatixhe Bashota dhe Musa Mazreku , anëtarë, me sekretaren juridike Fatime Hoti, në çështjen juridike të propozuesve I. R. nga fshati M. , e përfaqësuar nga B. Xh. avokate nga M., dhe S. R. nga fshati P. Komuna e Malishevës i përfaqësuar nga E. Xh., lidhur me zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, në shqyrtimin jo publik të mbajtur me dt. 29.11.2018 muar këtë.

A K T G J Y K I M

- I. **ZGJIDHET MARTESA ME SHKURORZIM** në mes të propozuesve I. R., e lindur me në M. , dhe S.R., i lindur me dt. ... në fshatin P., martesë e lidhur me dt.... në Zyrën e Gjendjes Civile në M.-L., certifikatë e evidentuar me nr. Rendor ... dhe numër të referencës, certifikatë e lëshuar me dt. 06.08.2018 në Zyrën e Gjendjes Civile në M.-L..

Secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Malishevë, me dt.07.08.2018 kanë parashtruar propozim për zgjidhjen e martesës me marrëveshje .

Sipas propozimit propozuesja dhe propozuesi kanë lidhur martesë me dt.27.12.1989 pranë Zyres së Gjendjes Civile në M.-L.. Raportet bashkëshortore në mesë palëve thuajse asnjëherë nuk kanë qenë stabile, kështu që gjatë kohës së martesës kanë pasur kriza, ndërsa së fundi në vitin ... gjatë kohës sa ndërëgjyqjësit kanë qenë në pushime në Kosovë, raportet e tyre u keqësuan në mënyrë serioze sa që erdhi edhe deri tek ndarja definitive dhe tani jetojnë ndaras. Gjatë kësaj martesë kanë të lindur tre fëmijë të cilët janë të moshës madhore.

Edhe për kundër përpjekjeve të familjareve dhe fëmijëve për pajtimin e bashkëshortëve kjo nuk është arritur sepse asnjëri nga ata nuk janë të interesuar për ruajtjen e kësaj martesë.

Kërkesë pasurore juridike ndaj njeri tjetrit nuk kanë parashtruar, me përjashtim të asaj që këtë martesë ta zgjidhin përmes rrugës gjyqësore dhe për këtë kanë autorizuar përfaqësuesit e tyre për ti përfaqësuar në procedurën e shkurorëzimit me marrëveshje.

Gjykata me dt. 29.11.2018 ka mbajtur seancën kryesore ku kanë prezantuar e autorizuar e propozueses si dhe i autorizuari i propozuesit .Gjykata nuk ka mbajtur seancën mbi pajtimin e bashkëshortëve për faktin së propozuesit jetojnë jashtë vendit.

E autorizuar e propozueses ka mbetur në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës me marrëveshje.

I autorizuari i propozuesit gjithashtu mbetet në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës me marrëveshje .

Gjykata shqyrtoj provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe atë certifikatën e martesës me nr. rendor ... dhe numër të referencës, e dt. 06.08.2018 leshuar nga zyra e gjendjes civile në M.-L.,ekstraktin e lindjes për L. R.,lindur me, G. R. lindur me dhe Q. R.,lindur me

Meqenëse propozuesit kanë mbetur pranë propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës, Gjykata bazuar në nenin 68 par.2 të Ligjet mbi Familjet e Kosovës, vendosi të zgjidhet martesa me shkurorëzim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse asnjëra nga palët nuk kanë parashtruar kërkesë për shpenzime procedurale, gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e sipërsënuara u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-dega në Malishevë/divizioni civil
C.nr. 186/18 me dt. 29.11.2018

Sekretarja Juridike
Fatime Hoti

Kryetari i trupit gjykues
Haki Kryeziu

UDHEZIM JURIDIK: Ky aktgjykim është i plotfuqishëm ditën e marrjes ,përkatësisht me dt. 29.11.2018 meqenëse të autorizuarit e palëve kanë hequr dorë nga parashtrimi i ankesës.